

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Titulli: **Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a., Adresa e AK: Sheshi "Bill Klinton" -13, 10000 Prishtinë**

Nr. i prokurimit: **IL-24-8711-2-2-1**

Nr. i brendshëm: **IL-24-040-221**

Sa i përket tenderit për Adresa e AK: **Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"ProAudit" SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Behar Begolli, Linda Premium

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

044/126395

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

///

(Numri i Faks-it)

Hajdar Hoxhaj,

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Proaudit34@gmail.com

(Adresa elektronike)

29.11.2024

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Njoftimi për kontratë, është publikuar në platëformën elektronike e prokurimi, më dt. 22.08.2024.

Afati i fundit për dorzimin e tenderit është përcaktuar nga AK deri me data: 30.10.2024, koha 14:00:00 AK më dt. 30.10.2024 ka publikuar Formularin B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve si:

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës nga OE
1.	Grupi i Operatorëve Ekonomik Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO-Ing SH.P.K.	89,900.00 €
2.	Grupi i Operatorëve Ekonomik ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K;	74,985.00€

AK më dt. 15.11.2024 ka dërguar NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES që shpërblen me kontratë: Grupi i Operatorëve Ekonomik Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO-Ing SH.P.K., në vlerë financiare prej: 89,900.00€ (tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind euro).

AK më dt. 15.11.2024 ka dërguar letër standarde për tenderuesin e eliminuar më arsyetimin si: "përkunder Kërkeses për Dorzimin e dëshmiave në lidhje me Kërkesen e përshtatshmerise se Kapacitetit teknik dhe Profesional, të dërgur nga AK me date 01.11.2024, nuk ka ofrur kopjen e Diplomes për kërkesen nr. 1.7. Nje (1) inxhinier i teknologjise infomative, andaj eshte e papershtatshme per dhenje te kontrates".

Me dt. 20.11.2024 nga Grupi i Operatorëve Ekonomik ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K., është dorzuar KËRKESË PËR RISHQYRTIM, pranë AK – NH "Ibër Lepenc" Sh.a., duke argumentuar dhe qartësuar se Grupi i Operatorëve Ekonomik Pro Acc Group SH.P.K.; H&N SH.P.K.; NIKA PrO-Ing SH.P.K., të cilin AK e shpërblen më kontratë, është i papershtatshëm për dhënie të kontrates, në 6 pika ankimore, duke theksuar se pjesa dërmuese e stafit profesional të kërkuar sipas dosjes së tenderit nuk plotësojnë kërkesat minimale të përshtatshmeris, përfshirë këtu edhe pozicionin kryesor "udhëheqës - menaxher i caktuar i projektit".

Edhe për kundër pikave ankimore, AK më dt. 22.11.2024 AK – ka publikuar Vendimin mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, duke lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK, që shpërblen më kontratë GOE, i cili është më i lartë me çmim në vlerë prej 14,915.00 euro, krahasuar më oferten më të lirë.

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit

Ne kemi vërejtur se kërkesat e përcaktuara për përbërjen e ekipit nuk janë identike në dosjen e tenderit dhe në specifikimet teknike. Po ashtu kemi vërejtur se vlerësimi i ofertave nuk është bërë sipas dispozitave të LPP dhe kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Pikat ankimore 1:

Për më tepër në Fletën e të Dhënave, tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" 9.1 & 9.2, kriteri i përzgjedhjes është përshkruar si në vijim: "Një (1) udhëheqës - menaxher i caktuar i projektit, përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve dhe sigurimin e përfundimit në kohë. Udhëheqësi i projektit duhet të jetë auditor ligjor dhe të ketë së paku 5 vite përvojë punë në auditim" ndërsa i njëjti kriter tek "Përbërja e grupit" të specifikimet teknike të detyrueshme është përshkruar ndryshe apo si "1 (një) udhëheqës - menaxher i caktuar i projektit, përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve dhe sigurimin e përfundimit në kohë. Udhëheqësi i projektit duhet të jetë auditor ligjor dhe të ketë së paku 5 vite përvojë punë në auditim si dhe të deshmojë me referenca se ka kryer së paku 1 projekt në rivlerësim të aseteve".

Mospërshkrimi identik dhe i qartë i këtij kriteri të përzgjedhjes bie ndesh me kërkesat e LPP dhe legjislacionit sekondar si dhe ka ndikuar në kufizim të pararsyeshëm të konkurrencës.

Gjatë vlerësimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk i kanë zbatuar kërkesat e nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të LPP dhe nenit 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, të RRPP. Për më tepër, ne kemi identifikuar se Grupi i Operatorëve Ekonomik "Pro Acc Group SH.P.K.; H&N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K." në ofertën e dorëzuar ka deklaruar informata të pa konfirmuara dhe të pasakta. Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE të dorëzojnë "Një listë e nënshkruar dhe vulosur nga OE që deshmon për stafin e angazhuar dhe e cila tregon emrin, mbiemrin dhe pozicionin per secilin staf" të dëshmuara me CV dhe referenca që dëshmojnë së stafi ka kryer punë të ngjashme.

Lidhur me këtë kriter kemi konstatuar se Grupi i Operatorëve Ekonomik "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K." ka këto mangësi:

Pika ankimore 2:

Hysen Ramabaja - i caktuar projekt menaxher është auditor ligjor, mirëpo nuk ka ofruar dëshmi/referencë se ka realizuar së paku një kontratë në rivlerësim të aseteve. Përveç kësaj referenca e dt. 20.06.2024 lëshur nga OE H & N SH.P.K., për z.Ramabaja që është dorëzuar në dosjen e tenderi nuk është dëshmi bindëse dhe as konfirmuese për përvojën e punës së tij në auditim, për faktin se referenca e tij nuk është lëshuar nga palët e treta, për të konfirmuar se z.Ramabaja apo OE H&N SH.P.K.; u ka ofruar shërbime profesionale – auditimit tek palët e treta, por është lëshuar nga vetë subjekti juridik OE H&N SH.P.K., duke mos përmbajtur të dhënat e personit përgjegjës i cili ka firmosur këtë dokument. Duke konsideruar, se z. Ramabaja - Drejtor (person i autorizuar) i OE H&N SH.P.K., i cili ka firmosur gjitha dokumentet e tjera në këtë proces duke përfaqësuar OE H&N SH.P.K., mund të vlerësojmë se referenca në fjalë është lëshuar nga vetë z.Ramabaja për vetën e tij, dhe si e tillë nuk arrin objektivin e përcaktuar nga AK.

Pika ankimore 3:

Izahir Kuka – inxhinier i ndërtimitarisë – drejtimi i hidros, nuk ka ofruar referenca për përvojën e tij të punës prej 3 viteve në fushën e hidros siç është përcaktuar më dosjen e

tenderit. Referencat që i ka ofruar GOE për z.Izahir Kuka, që dëshmojnë përvojën e tij të punës përmbajnë *vetëm për 2 vjet, 6 muaj, 21 ditë* apo mbulojnë periudhën kohore nga data 20.04.2022 deri 10.11.2024. Si të tilla këto referenca nuk e plotësojnë kërkesën e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe nuk janë në harmoni përkatësisht përputhje me angazhimet në punë, të cilat z.Izahir Kuka i ka deklaruar në CV e tij. Njëra nga referencat e z.Izahir Kuka mbanë datën e lëshimit 10.11.2024, datë kjo pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit që ishte data 30.10.2024. Po ashtu theksoj se Referenca e leshuara nga shoqëria InvestPro dhe NikaPro, nuk janë paraqitur tek CV e zt. Izahir Kuka. Theksojmë se sipas Formularit për deklarimin e pasurisë për vitin 2023 dhe 2024 pranë Agjencionit për Parandalimin e Korrupsionit, kuptohet qartë se z. Kuka posedon pozitën *"Zyrtar i Lartë i Prokurimit"* - Komuna e Kaçanikutur nga dt. 01.06.2004, i cili ka deklaruar se: *"Përveq pages nuk kam të ardhura tjera personale"*. Kjo e ben të kuptueshme faktin që referencat nga EO për z. Kuka nuk përmbajnë elemente besueshmerie.

Gjithashtu theksojmë se zt. Kuka, u.d Menaxheri i Prokurimit në Komunen e Kaçanikutur, ka nënshkruar kontratën me nr. Prokurimi: 01-370/01-2017/24 dt. 20.08.2024 më OE "NIKA PRO-ING" SH.P.K. më titull "Rregullimi i hapsirave recreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë, në çmim total prej: 73,643.96Euro, në afat kohor për përfundimin e gjitha puneve deri më 15.12.2025, gjersa i njajti (z. Kuka) më dt. 30.10.2024 ka firmosur Kontraten më kohe të caktuar më OE "NIKA PRO-ING" SH.P.K., për angazhimin e tij në realizimin e tenderit Titulli: Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrje Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a., nëse GOE shpallet fitues. Lidhur më këtë ne konsiderojmë se z. Kuka më nënshkrimin e kontratës se lartë cekur, shkaktohet konflikt i interes në rast të angazhimit në projektin në fjalë.

Pika ankimore 4:

Ardian Morina - Teknologjia Informative - referencat e prezantuara nuk e mbulojnë përvojën e kërkuar në dosjen e tenderit për kohëzgjatje prej 3 viteve. Data e lëshimit të referencave nuk është në harmoni me periudhën për të cilën janë lëshuar referencat. Kompania AFA-Ing, ka lëshuar referencën me datë 02.03.2018, ndërsa periudha për të cilën është lëshuar referenca është 29.06.2015 - 26.03.2018, pra data e lëshimit të referencës është para përfundimit të periudhës për të cilën është lëshuar referenca. Periudha kohore e mbuluar nga kjo referencë është 2 vite e 8 muaj e 26 dite dhe jo 3 vite sic është kërkuar në dosjen e tenderit. Tutje, referenca e lëshur nga X sh.p.k., përmban datën 20.03.2016, kurse është lëshuar për periudhën 2014-2018, pra edhe kjo referencë është para datës së përfundimit të angazhimit. Referencat janë dëshmi që lëshohen për të konfirmuar se angazhimi është kryer me sukses, prandaj në rastin e këtijë punonjësi, lëshimi i referencave para përfundimit të angazhimit pa diskutim që e vë në dyshim seriozitetin e referencës dhe kohëzgjatjen e angazhimit.

Pika ankimore 5:

Qemail Qehaja - Inxhinier i diplomuar i Makinërisë ka ofruar referenca në ofertën e GOE, mirëpo të njëjtat nuk janë në harmoni me CV e prezantuar dhe firmosur nga zt. Qehaja. Është ofruar një kontratë e nënshkruar nga zt. Qehaja dhe OE NIKA PrO- Ing SH.P.K., me dt. 26.02.2024, ndërsa po i njëjti OE NIKA PrO- Ing SH.P.K. i ka lëshuar referencë zt. Qehaja për kinse projekte në të cilat është angazhuar për vitet 2017-2022, 2019-2020. Pra kjo referencë që është lëshuar në vitin 2023 nuk është e bazuar në kontratë dhe angazhimi për të cilin është lëshuar referenca nuk është prezantuar në CV e zt.Qehaja.

Pika ankimore 6:

Se procesi i vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a. IL-24-8711-2-2-1" nuk është kryer si duhet dëshmohet edhe nga raporti i vlerësimit në të cilin vlefshmëria e ofertave për të dy GOE është plotësuar 90 ditë, ndërsa në ofertat e tyre, vlefshmëria e tenderit është dhënë për 60 ditë.

Pika ankimore 7:

Në ofertën e GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K." që e kemi marr gjatë qasjes në dokumente janë prezantuar dy polisa të sigurimit të tenderit. Njëra është lëshuar me datë 28.10.2024 dhe ka numër të polisës 060010330097844, ndërsa tjetra është lëshuar me datë 30.10.2024 dhe me numër të polises 060010330097780. Po ashtu këto dy polisa të sigurimit janë ngarkuar në platformën e-prokurim në data të ndryshme, e para është dorëzuar së bashku me ofertën, ndërsa e dyta është ngarkuar në e-prokurim se bashku me dokumentet tjera para publikimit të vendimit për dhënien e kontratës. Një dallim tjetër në këto polisa është edhe përbërja e GOE, rrjedhimisht në polisën e parë si pjestar në GOE janë dy OE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.", ndërsa në polisën e dytë GOE përbëhet nga tre OE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K."

Pika ankimore 8:

Behar Januzi, Espert gjyqësor i vlerësimit të pronave të paluajtshme, sipas Aktvendimit nr. CN.nr.298/20 dt. 02.08.2022 nga Gjykata Themelore Ferizaj, më të cilin refuzohet në tërsi propozimi për shpronzim në shumë të përgjithshme 524,624.00Euro, e cila shumë është në mendimin e ekspertit vlerësues Behar Jonuzi. Pra sipas këtij Aktvendimit, mund të vlerësojmë se z. Jonuzi nuk posedon begrand të nivelit të lartë gjatë ushtrimit të profesionit të tij si vlerësues i pronave.

Bazuar në çështjet e ngritura më lartë vërehet se procesi i vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a. IL-24-8711-2-2-1" nuk është bërë në bazë kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe është shkelur neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të LPP dhe neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve I RRPP-së. Pra, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Është shkelur edhe neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, sipas të cilit të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ngase AK ka propozuar t'i ipet kontrata GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K.", i cili është më i lartë me çmim sesa ofertuesi më i lirë për vlerën prej 14,915.00 euro, edhe për kundër që i njehti nuk plotëson kriteret sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Gjatë vlerësimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit dhe ZPP e kanë shkelur nenin Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, duke i prezantuar në raportin e vlerësimit vetëm kriteret e përzgjedhjes që GOE "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K" nuk i ka plotësuar. Në anën tjetër, duke e shkelur LPP dhe legjislacionin sekondar i kanë anashkaluar të gjitha kriteret e përzgjedhjes që GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K." nuk i ka plotësuar dhe kanë marrë vendim që të njëjtin edhe pse i papërgjegjshëm ta propozojnë për dhënien e kontratës.

GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA Pro- Ing SH.P.K." nuk ka vepruar sipas qëllimit të Deklaratës nën Betim për arsye se përvoja e stafit e prezantuar në "Listën e stafit profesional" nuk është vërtetuar me referencat dhe CV e tyre. Rrjedhimisht kjo nenkupton se lista e stafit nuk përmban informacione të besueshme, që nënkupton kriteri i paplotësuar nga GOE. Po ashtu referencat e dorzuar nga GOE përmbajnë informata jo të sakta.

Për ne mbetet e pa kuptuar dhe tejet i pa qartë, Vendimi arbitrar dhe i paargumentuar nga AK - Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A., mbi Refuzimin e Kërkeses për Rishqyrimi, edhe për kunder ofrimin të sqarimeve tejet relevante. Për më shumë si zyrtar përgjegjës, brenda kompetencave dhe përgjegjësi përkatëse nga AK, do konsideronim ushtrim profesional trajtimin e dokumenteve më informata të pasakta, dhe parashtimin e kërkesës eventuale pran OSHP, në mënyrë që kjo e fundit të veproj në përputhje me nenin 99 paragrafi 2 ndaj GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA Pro- Ing SH.P.K.

Referuar leter standarde për tenderin e eliminuar, AK ka vlerësuar se Grupi i Operatoreve Ekonomi "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K, i mungon kopje e diplomes për kërkesen nr. 1.7. Një (1) inxhinier i teknologjis informative, mirëpo AK nuk e ka konsideruar si deshmi Certificate / Konfirmimin më të cilin deshmon se inxhinier i teknologjis informative ka përfunduar më sukses të gjitha provimet. Përkatësisht AK nuk ka vepruar në përputhje më LPP nenit 64 i cili thekson "Një kandidat ose tenderues do të dëshmoj me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të njaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues", duke mos marrë për bazë parime e përgjithshme të LPP në përgjithësi dhe kërkesa e LPP neni 6 në veçanti.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, mirëpresim, rrjedhimisht kërkojmë nga OSHP që në përputhje me LPP Nr. 04/L-042, ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, që pas shqyrtimit të kësaj ankese, vlerësimin dhe administrimit të provave , të merr;

VENDIM

I. APROVOHET, si e bazuar Ankesa nga Grupi i Operatoreve Ekonomi "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K:

II. ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe Vendimin mbi Refuzimin e Kërkeses për Rishqyrimi:

III. SHPËRBLEHET MË KONTRATË, Grupi i Operatoreve Ekonomi "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K., Pasur parasysh faktin që ZKA ndër vite është duke kualifikuar opinionin e AK, më bazë mos rivlersimin e aseteve, konsiderojmë se rëndësia e këtij projekti është në interes të AK, si dhe marrë parasysh praktikën e OSHP sipas vendimit OSHP: 2024/0613 si dhe bazuar në nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se "Ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik".

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE IBËR LEPENC SH.A. në aktivitetin e prokurimit "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a. IL-24-8711-2-2-1" nuk e ka respektuar Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloren për Prokurim Publik në nenet në vijim :

- Neni 1 i LPP-së
- Neni 6 i LPP-së
- Neni 7 i LPP-së
- Neni 27 i LPP-së
- Neni 28 i LPP-së
- Neni 56 i LPP-së
- Neni 59 i LPP-së
- Neni 64 i LPP-së
- Neni 17 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
- Neni 19 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
- Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Mos shpërblimi më kontratë GOE "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K., edhe për kundër plotësimin përmbajtësor të kriterëve sipas Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat, është në kundërshtim më LPP, Rregulat e prokurimit publik dhe Udhëzimeve operative.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, përkatësisht dhënie e kontratë Grupi i Operatorëve Ekonomik Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO-Ing SH.P.K., për një shumë prej: 89,900.00 Euro, edhe për kundër që i njajti nuk ka plotësuar kërkesat e përshtatëshmerisë, ka reflektuar në dëmtimin e buxhetit të AK në vlerë financiare prej; 14,915.00 euro.

Të bashkangjitur gjeni dëshmi;

- Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i dt. 22.11.2024 nga AK;
- Kontrata më nr. Prokurimi: 01-370/01-2017/24 dt. 20.08.2024 në mes të AK – Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga z. Izahir Kuka, u.d Menaxheri i Prokurimit dhe OE "NIKA PRO-ING" SH.P.K.;
- Formulari për deklarinimit të pasurisë për vitin 2023 dhe 2024 pranë Agjencionit për Parandalimin e Korrupsionit nga zt. Izahir Kuka;
- Aktvendimit nr. CN.nr.298/20 dt. 02.08.2022 nga Gjykata Themelore Ferizaj;
- Vendimi nr. OSHP: 2024/0613 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit:

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mos shpërblimi i ofertuesit, sjellë disa dëmi materiale për GOE "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K., si në vijim;

- i) Kosto e përgaditjes së ofertës; GOE "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K., ka investuar në kohe, para, dhe burime profesionale financiare, teknike, operative, etj në përgaditjen e ofertës. Mos shpërblimi i tenderit, rezulton në humbje të katër burimeve.
- ii) Humbja e mundësisë për të fituar kontratën, GOE "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K., kishte planifikuar të fitonte kontratën, dhe nuk arrinë të shpërblehet, duke e humb mundësin tejet të rëndësishme për të siguruar/fitur një kontrat të re.
- iii) Ndikimi në reputacionin e GOE "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K. Mos shpërblimi i tenderit dhe mos shpërblimi i ofertës, ndikon negativisht në raputacionin. Përkatësisht ky veprim i AK – NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE IBËR LEPENC SH.A., mund të shkaktoj dyshime mbi cilësin e shërbimëve dhe produkteve të sajë.

- iv) Ndalimi nga tenderime tjera, ne raste te tilla mos shperblimi i ofertës mund te shkaktoje ndalim perkohesisht ose te perhershëm nga të tjera tenderime të organizatave të ngjajshme.

Keto janë vetem disa nga dëmet potenciale që i shkaktohen OE – Person Fizik, nga mos shpërblimi i ofertës.

Është e rëndësishme për aktivitetin e prokurimit “Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH “Ibër Lepenc” Sh.a, në veçanti dhe procesin e prokurimit në përgjithsi, që AK – Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc Sh.A, të veproj në mënyrë të përgjegjshme gjatë procesit të tenderimit, për të zvogluar keto rreziqe dhe për të siguruar transparencë dhe drejtësi në procedurat e saj, në përputhje të plotë me LPP.

Përkatësisht organizatat përkatëse si OSHP dhe / ose KRPP, të ndërmarrin veprimet e duhura ligjore më qëllim forcimin e kontroleve të brendshme në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit, përfshir edhe Komunen e Kaçanikut.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bill Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a.

Numri i aktivitetit të prokurimit: IL-24-8711-2-2-1

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K., Rruga Venet Bajrami, Blini 2, Hymja-A, Nr.25, 10000, Prishtinë	89,900.00 €
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K., Rr. Behar Begolli, Linda Premium, Obj. C2, 10000, Prishtinë	74,985.00 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

NH "Ibër Lepenc" Sh.a. shpërblen me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik "Pro Acc Group SH.P.K.; "H & N" SH.P.K.; "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., me vlerë totale të ofertës 89,900.00 EURO.

Data: 15.11.2024

Emri dhe mbiemri i ZPP: Mimoza Zeqiri



Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm¹

Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A., Sheshi "Bill Clinton" -13 10000 PRISHTINË

Për: Grupin e Operatorëve Ekonomik "Pro Acc Group SH.P.K.; "H & N" SH.P.K.; "NIKA PrO- Ing" SH.P.K.,

Data: 15.11.2023

Nr i Prokurimit	IL-24-8711-2-2-1
Nr i brendshëm	IL-24-040-221

Titulli: "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a."

I/e nderuar(a) [Z/Znj]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm** si përgjigje ndaj **njoftimit të kontratës** për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj prej **89,900.00 EURO me TVSH** dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit të intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Me respekt,

Mimoza Zeqiri

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrimi]

¹ Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata



B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ¹

Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A., Sheshi "Bill Clinton" -13 10000 PRISHTINË

Për: Grupin e Operatorëve Ekonomik "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K.

Data: 15.11.2024

Nr i Prokurimit	IL-24-8711-2-2-1
Nr i brendshëm	IL-24-040-221

Titulli: "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a."

I/e nderuar(a) [Z/Znj]] [shëno emrin e personit kontaktues të operatorit ekonomik]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit] [dokumentet parakualifikuese]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye : Komisioni i vleresimit konstaton se Grupi i Operatorëve Ekonomik ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K., eshte i paparanueshem për këto arsye se:

- perkunder Kerkeses per Dorezimin e deshmive ne lidhje me Kerkesen e Pershtatshmerise se Kapacitetit teknik dhe Profesional, te derguar nga AK me date 01.11.2024, nuk ka ofruar kopjen e Diplomes per kerkesen nr. 1.7. Një (1) inxhinier i teknologjisë informative, andaj eshte e papshtatshme per dhenje te kontrates, por ka ofruar Certificate qe deshmonte se ka perfunduar provimet dhe është duke punuar në Temën e Diplomës.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt, Mimoza Zeqiri

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

(Nënshkrimi)

¹ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bill Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@ iber-lepenc.org

Për: Operatorin Ekonomik "ProAudit" SH.P.K.
Nga: Mimoza Zeqiri,
Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit – NH "Ibër Lepenc" Sh.a.
Date: 22.11.2024
Lënda: Vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim për tenderin:
"Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a."

NH „Ibër Lepenc” Sh.a duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik "ProAudit" SH.P.K., lidhur me tenderin "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a." me numër të prokurimit IL-24-8711-2-2-1 i inicuar me datën 22.08.2024, NH „Ibër Lepenc“ Sh.a. merr këtë:

VENDIM MBI REFUZIMIN E KERESSES PER RISHQYRTIM

Me datën 20.11.2024 në ora 12:01, Operatori Ekonomik "ProAudit" SH.P.K. ka paraqitur në platformën elektronike të prokurimit Kërkesë për rishqyrtim lidhur me tenderin "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a." me numër të prokurimit IL-24-8711-2-2-1, i publikuar nga AK NH "Ibër Lepenc" Sh.a me datën 22.08.2024.

Pretendimet nga 1 në 6 të Operatorit Ekonomik "ProAudit" SH.P.K. janë si në vijim:

Faktet dhe argumentet e paraqitura:

Kronologjia e aktivitetit të prokurimit "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a. IL-24-8711-2-2-1"

Në aktivitetin e prokurimit "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a. IL-24-8711-2-2-1" kanë ofertuar dy GOE, GOE "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K." dhe GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K."

Për dhënien e kontratës është propozuar GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K.", me çmim të ofertës prej: 89,900.00 Euro, i cili është më i lartë me çmim sesa ofertuesi më i lirë për vlerën prej 14,915.00 euro.

Ne kemi vërejtur se kërkesat e përcaktuara për përbërjen e ekipit nuk janë identike në dosjen e tenderit dhe në specifikimet teknike. Po ashtu kemi vërejtur se vlerësimi i ofertave nuk është bërë sipas dispozitave të LPP dhe kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Për më tepër në Fletën e të Dhënave, tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" 9.1 & 9.2, kriteri i përzgjedhjes është përshkruar si në vijim: "Një (1) udhëheqës - menaxher i caktuar i projektit, përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve dhe sigurimin e përfundimit në kohë. Udhëheqësi i projektit duhet të jetë auditor ligjor dhe të ketë së paku 5 vite përvojë punë në auditim" ndërsa i njëjti kriter tek "Përbërja e grupit" të specifikimet teknike të detrvueshme është përshkruar ndryshe apo si "1 (një) udhëheqës - menaxher i caktuar i projektit, përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve dhe sigurimin e përfundimit në kohë. Udhëheqësi i projektit duhet të jetë auditor ligjor dhe të ketë së paku 5 vite përvojë punë në auditim si dhe të deshmojë me referenca se ka kryer se paku 1 projekt të rivlerësimit të asetëve".

1. Hysen Ramabaja - i caktuar projekt menaxher është auditor ligjor, mirëpo nuk ka ofruar dëshmi/referencë se ka realizuar së paku një kontratë në rivlersim të aseteve. Përveç kësaj referenca për z.Ramabaja që është dorëzuar në dosjen e tenderi nuk është dëshmi bindëse dhe as konfirmuese për përvojën e punës së tij në auditim, për faktin se referenca e tij nuk është lëshuar nga palët e treta, të cilave z.Ramabaja u ka ofruar shërbime, por është lëshuar nga vetë z.Ramabaja për vetën e tij.
2. Izahir Kuka – inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi i hidros, nuk ka ofruar referenca për përvojë e tij të punës prej 3 viteve në fushën e hidros sic është përcaktuar më dosjen e tenderit. Referencat që i ka ofruar GOE për z.Izahir Kuka, dëshmojnë përvojën e tij të punës përmban *vetëm për 2 vjet, 6 muaj, 21 ditë* apo mbulojnë periudhën kohore nga data 20.04.2022 deri 10.11.2024. Si të tilla këto referenca nuk e plotësojnë kërkesën e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe nuk janë në harmoni përkatësisht përputhje me angazhimet në punë, të cilat z.Izahir Kuka i ka deklaruar në CV e tij. Njëra nga referencat e z.Izahir Kuka mbanë datën e lëshimit 10.11.2024, datë kjo pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit që ishte data 30.10.2024. Po ashtu theksoj se Referenca e leshuara nga shoqeria InvestPro dhe NikaPro, nuk jane paraqitur tek CV e zt. Izahir Kuka.
3. Ardian Morina – Teknologjia Informative – referencat e prezantuar nuk e mbulojnë përvojën e kërkuar në dosjen e tenderit për kohëzgjatje prej 3 viteve. Data e lëshimit të referencave nuk është në harmoni me periudhën për të cilën janë lëshuar referencat. Kompania AFA-Ing, ka lëshuar referencën me datë 02.03.2018, ndërsa periudha për të cilën është lëshuar referenca është 29.06.2015 – 26.03.2028, pra data e lëshimit të referencës është para përfundimit të periudhës për të cilën është lëshuar referenca. Periudha kohore e mbuluar nga kjo referencë është 2 vite e 8 muaj e 26 dite dhe jo 3 vite sic është kërkuar në dosjen e tenderit. Tutje, referenca e lëshur nga X sh.p.k., përmban datën 20.03.2016, kurse është lëshuar për periudhën 2014-2018, pra edhe kjo referencë është para datës se përfundimit të angazhimit. Referencat janë dëshmi që lëshohen për të konfirmuar se angazhimi është kryer me sukses, prandaj në rastin e këtijë punonjësi, lëshimi i referencave para përfundimit të angazhimit pa diskutim që e vë në dyshim seriozitetin e referencës dhe kohëzgjatjen e angazhimit.
4. Qemail Qehaja – Inxhinier i diplomuar i Makinërisë ka ofruar referenca në ofertën e GOE.

mirëpo të njëjtat nuk janë në harmoni me CV e prezantuar dhe firmosur nga zt. Qehaja. Është ofruar një kontratë e nënshkruar nga zt. Qehaja dhe OE NIKA PrO- Ing SH.P.K., me dt. 26.02.2024, ndërsa po i njëjti OE NIKA PrO- Ing SH.P.K. i ka lëshuar referencë zt. Qehaja për kinse projekte në të cilat është angazhuar për vitet 2017-2022, 2019-2020. Pra kjo referencë që është lëshuar në vitin 2023 nuk është e bazuar në kontratë dhe angazhimi për të cilin është lëshuar referenca nuk është prezantuar në CV e zt.Qehaja.

5. Se procesi i vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a. IL-24-8711-2-2-1" nuk është kryer si duhet dëshmohet edhe nga raporti i vlerësimit në të cilin vlefshmëria e ofertave për të dy GOE është plotësuar 90 ditë, ndërsa në ofertat e tyre, vlefshmëria e tenderit është dhënë për 60 ditë.
6. **Në ofertën e GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K." që e kemi marr gjatë qasjes në dokumente janë prezantuar dy polisa të sigurimit të tenderit. Njëra është lëshuar me datë 28.10.2024 dhe ka numër të polisës 060010330097844, ndërsa tjetra është lëshuar me datë 30.10.2024 dhe me numër të polisës 060010330097780. Po ashtu këto dy polisa të sigurimit janë ngarkuar në platformën e-prokurim në data të ndryshme, e para është dorëzuar së bashku me ofertën, ndërsa e dyta është ngarkuar në e-prokurim së bashku me dokumentet tjera para publikimit të vendimit për dhënien e kontratës. Një dallim tjetër në këto polisa është edhe përbërja e GOE, rrjedhimisht në polisën e parë si pjestar në GOE janë dy OE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K., ndërsa në polisën e dytë GOE përbëhet nga tre OE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K."**

Bazuar në çështjet e ngritura më lartë vërehet se procesi i vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a. IL-24-8711-2-2-1" nuk është bërë në bazë kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe është shkelur neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të LPP dhe neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve I RRPP-së. Pra, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Është shkelur edhe neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, sipas të cilit të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ngase AK ka propozuar t'i ipet kontrata GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K.", i cili është më i lartë me çmim sesa ofertuesi më i lirë për vlerën prej 14,915.00 euro.

Gjatë vlerësimit të ofertave Komisioni i Vlerësimit dhe ZPP e kanë shkelur nenin Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, duke i prezantuar në raportin e vlerësimit vetëm kriteret e përzgjedhjes që GOE "ProAudit SH.P.K.; LEGAL SOLUTION COMPANY SH.P.K" nuk i ka plotësuar. Në anën tjetër, duke e shkelur LPP dhe legjislacionin sekondar i kanë anashkaluar të gjitha kriteret e përzgjedhjes që GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K." nuk i ka

plotësuar dhe kanë marrë vendim që të njëjtin edhe pse i papërgjegjshëm ta propozojnë për dhënien e kontratës.

GOE "Pro Acc Group SH.P.K.; H & N SH.P.K.; NIKA PrO- Ing SH.P.K." nuk ka vepruar sipas qëllimit të Deklaratës nën Betim për arsye se përvoja e stafit e prezantuar në "Listën e stafit profesional" nuk është vërtetuar me referencat dhe CV e tyre. Rrjedhimisht kjo nënkupton se lista e stafit nuk përmban informacione të besueshme, që nënkupton kriteri i paplotësuar nga GOE.

Përgjigje nga NH „Ibër Lepenc“ Sh.a.

Specifikat Teknike janë vendosur në Dosje të Tenderit (DT) sipas Kërkesës njga Njësia e Kërkesës dhe janë në Aneks, ndërsa, Kërkesat e Përshtatshmërisë janë të vendosura në Fletën e të Dhënave (FTD), e cila dominon mbi atë se çka është shkruar në Specifikacionin Tekniik.

Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar duke u bazuar saktësisht në Kërkesat e Fletës së të Dhënave!

Përgjigje ndaj Pretendimit 1:

Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar se Referenca për z. H. Ramabaja është lëshuar nga Kompania H&N SH.P.K. dhe jo nga vetja e tij, siç e keni potencuar.

Përgjigje ndaj Pretendimeve 2, 3 dhe 4:

Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar drejtë se z. I. Kuka, z. A. Morina dhe z. Q. Qehaja i kanë përmbushur kriterin e nevojshëm tre (3) vjeçar, siç kërkohet me referenca, pavarësisht se se nuk janë paraqitur në CV'të e tyre.

Përgjigje ndaj Pretendimit 5:

Vlefshmëria e Ofertave është e përcaktuar '60 ditë' në Fletën e të Dhënave, dhe të Grupet e Operatorëve Ekonomik e kanë respektuar këtë afat. Andaj, pretendimi I juaj se ky kriter nuk është plotësua ng ate dy ofertuesit (përfshirë edhe vetën tuaj) nuk qëndron.

Përgjigje ndaj Pretendimit 6:

Pavarësisht se janë dy Polisa të Sigurimit të Tenderit, që te dyja e kanë plotësuar afatin e kërkuar prej 90 ditësh, konform kërkesës së paraqitur në Fletën e të Dhënave.

Duke u bazuar në sqarimet e dhëna më lartë rreth vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit, dhe vlerësimit të tyre të tërësishëm ku Ju jeni konsideruar me ofertë të papërgjegjshme, duke qenë se edhe pas Kërkesës për Dokumente Shtesë, ju nuk e keni plotësuar kërkesën e dëshirueshme, andaj nuk mund të konsideroni se ofertat nuk janë vlerësuar në mënyrë të barabartë, sipas kërkesave ligjore. Gjithashtu, rreth Referencave të sipërpërmendura, Komisioni i Vlerësimit e ka pasur të drejtën që Referencat për secilin kandidat të i kërkoj edhe me Kërkesë për Sqarim të Tenderit. Mirëpo, duke qenë se e ka konsideruar si të panevojshme një kërkesë të tillë, nuk e kanë bërë.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë, AK NH „Ibër Lepenc“ Sh.a. e refuzon Kërkesën për Rishqyrtim nga “Pro Acc Group SH.P.K.” shpk.

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të bëjë ankesë në OSHP.

Vendimi publikohet:

Në platformën elektronike të prokurimit në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>



Regjistër për deklarimin e pasurisë

DEKLARIMI I RREGULLT VJETOR

TË DHËNAT PERSONALE TË DEKLARUESIT

Emri	Izahir	Mbiemri	Kuka
Funksioni	Zyrtar i Lartë i Prokurimit		
Emri i institucionit	Komuna e Kaçanikut		
Adresa e institucionit	Kaçanik		
Njësia organizative	Zyra e Kryetarit	Data e emërimit	01.06.2004

TË DHËNAT E ZYRTARIT TË LARTË PUBLIK

Nr.	Emri i institucionit	Adresa e institucionit	Njësia organizative	Funksioni	Data e emërimit
1	Komuna e Kaçanikut	Kaçanik	Zyra e Kryetarit	Zyrtar i Lartë i Prokurimit	01.06.2004

FUNKSIONET OSE AKTIVITETET E TJERA QË I KRYEN ZYRTARI I LARTË PUBLIK, KRAHAS FUNKSIONIT ZYRTAR

Nr.	Lloji i institucionit	Emri i institucionit	Qyteti	Adresa e institucionit	Njësia organizative	Niveli i pozitës	Funksioni	Data e emërimit	Data e përfundimit
Nuk ka të dhëna									

PASURITË E PALUAJTSHME

Nr.	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja	Prejardhja e pasurisë	Origjina dhe/ose mënyra e blerjes apo përfitimit	Viti i përfitimit	Vlera/Çmimi	Pronësia e
1	Shtëpi	270.00 m2	E ndërtuar	Nga kredia dhe nga ndihmat familjare	2018	80,000.00 €	Deklaruesit
2	Arë	1000.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	5,000.00 €	Deklaruesit
3	Arë	3384.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	7,000.00 €	Deklaruesit
4	Arë	880.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	1,000.00 €	Deklaruesit
5	Arë	1557.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	15,000.00 €	Deklaruesit
6	Arë	224.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	14,000.00 €	Deklaruesit
7	Arë	1104.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	65,000.00 €	Deklaruesit

PASURITË E LUAJTSHME, MBI TREMIJË (3,000.00) EURO

Nr.	Lloji i pasurisë	Prejardhja e pasurisë	Origjina dhe/ose mënyra e blerjes apo përfitimit	Pjesë të veqanta	Viti i përfitimit	Vlera/Çmimi	Pronësia e
1	Veture(Volkswagen)	E blerë	Nga Kredia	Jo	2020	8,000.00 €	Deklaruesit

ZOTËRIMI I AKSIONEVE NË SHOQËRI TREGTARE

Nr.	Lloji i shoqërisë tregtare	Emri i shoqërisë tregtare	Përqindja e aksioneve	Vlera në Euro	Data e regjistrimit	Data e përfitimit të aksioneve	Aksionet e
Nuk ka të dhëna							

POSEDIMI I LETRAVE ME VLERË

Nr.	Letra me vlerë	Vlera e letrës /€	Burimi	Data e pranimit	Letra e
Nuk ka të dhëna					

POSEDIMI I KRIPTOVALUTËS

Nr.	Emri i kryptovalutës	Vlera e tanishme /€	Vlera e blerjes €	Sasia	Prejardhja	Data e pranimit	Letra e
Nuk ka të dhëna							

PARA TË GATSHME NË LLOGARI RRJEDHËSE, NË DEPOZITA DHE NË HUADHËNIE NË EURO OSE NË VALUTA TJERA TË HUAJA

Nr.	Lloji i të hyrave	Emri i institucionit	Vendi	Vlera/Çmimi	Prejardhja	Lloji i llogarisë	Pronësia e
1	Bank	Procredit Bank	Kosovë	2.48 Euro	Paga	Depozita/kursime	Deklaruesit
2	Bank	Procredit Bank	Kosovë	100.00 Euro	Paga	Depozita/kursime	Bashkëshorti/ës
3	Bank	Procredit Bank	Kosovë	10.00 Euro	Kursime	Depozita/kursime	Fëmijëve (me të cilët jeton në bashkësi familjare)
4	Bank	Procredit Bank	Kosovë	10.00 Euro	Kursime	Depozita/kursime	Fëmijëve (me të cilët jeton në bashkësi familjare)

TË DREJTAT DHE DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIK DHE FIZIK

Nr.	Kreditor (E Drejta)	Debitor (Detyrim)	Qëllimi i detyrimit financiar	Data e fillimit	Data e mbarimit	Kohëzgjatja (muaj)	Vlera Fillestare	Vlera e mbetur (aktuale)	Shuma totale e kredisë	Detyrimet e
1	Procredit Bank		Ndërtim Shtepie	29.07.2019	02.11.2029	120	30,000.00 €	18,670.12 €	30,000.00 €	Deklaruesit

DONACIONET NË PARTI POLITIKE

Lloji Donacionit	Parti politike	Vlera në €	Emërtimi	Data	Qëllimi	Pronësia
Nuk ka të dhëna						

DONACIONET DHE SHPENZIMET

Lloji Donacionit	Vlera në €	Emërtimi	Data	Qëllimi	Pronësia
Nuk ka të dhëna					

TË ARDHURAT VJETORE PERSONALE DHE FAMILJARE

Pronësia e	Lloji i të hyrave	Burimi	Vendi	Banka	Shuma /€	Teksti nese nuk ka
Deklaruesit			Kosovë	Cash	0.00	Perveq Pages nuk kam te ardhura tjera personale
Deklaruesit	Pagat neto përmes listës së pagave	Komuna e Kaçanikut	Kosovë	Procredit Bank	6,624.00 €	
Bashkëshortit/ës	Pagat neto përmes listës së pagave	Paga Nga Buixheti i Republikës së Kosovës	Kosovë	Procredit Bank	6,408.00 €	

TË DHËNA TË TJERA

--



Regjistër për deklarimin e pasurisë

DEKLARIMI I RREGULLT VJETOR

TË DHËNAT PERSONALE TË DEKLARUESIT

Emri	Izahir	Mbiemri	Kuka
Funksioni	Zyrtar i Lartë i Prokurimit		
Emri i institucionit	Komuna e Kaçanikut		
Adresa e institucionit	Kaçanik		
Njësia organizative	Zyra e Kryetarit	Data e emërimit	01.06.2004

TË DHËNAT E ZYRTARIT TË LARTË PUBLIK

Nr.	Emri i institucionit	Adresa e institucionit	Njësia organizative	Funksioni	Data e emërimit
1	Komuna e Kaçanikut	Kaçanik	Zyra e Kryetarit	Zyrtar i Lartë i Prokurimit	01.06.2004

FUNKSIONET OSE AKTIVITETET E TJERA QË I KRYEN ZYRTARI I LARTË PUBLIK, KRAHAS FUNKSIONIT ZYRTAR

Nr.	Lloji i institucionit	Emri i institucionit	Qyteti	Adresa e institucionit	Njësia organizative	Niveli i pozitës	Funksioni	Data e emërimit	Data e përfundimit
Nuk ka të dhëna									

PASURITË E PALUAJTSHME

Nr.	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja	Prejardhja e pasurisë	Origjina dhe/ose mënyra e blerjes apo përfitimit	Viti i përfitimit	Vlera/Çmimi	Pronësia e
1	Banesë	270.00 m2	E ndërtuar	Nga kredia dhe nga ndihmat familjare	2018	80,000.00 €	Deklaruesit
2	Arë	1000.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	5,000.00 €	Deklaruesit
3	Arë	3384.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	7,000.00 €	Deklaruesit
4	Arë	880.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	1,000.00 €	Deklaruesit
5	Arë	1557.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	15,000.00 €	Deklaruesit
6	Arë	224.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	14,000.00 €	Deklaruesit
7	Arë	1104.00 m2	E trashëguar	E trashëguar	2021	65,000.00 €	Deklaruesit

PASURITË E LUAJTSHME, MBI TREMIJË (3,000.00) EURO

Nr.	Lloji i pasurisë	Prejardhja e pasurisë	Origjina dhe/ose mënyra e blerjes apo përfitimit	Pjesë të veqanta	Viti i përfitimit	Vlera/Çmimi	Pronësia e
1	Veture(Volkswagen)	E blerë	Nga Kredia	Jo	2020	8,000.00 €	Deklaruesit

ZOTËRIMI I AKSIONEVE NË SHOQËRI TREGTARE

Nr.	Lloji i shoqërisë tregtare	Emri i shoqërisë tregtare	Përqindja e aksioneve	Vlera në Euro	Data e regjistrimit	Data e përfitimit të aksioneve	Aksionet e
Nuk ka të dhëna							

POSEDIMI I LETRAVE ME VLERË

Nr.	Letra me vlerë	Vlera e letrës /€	Burimi	Data e pranimit	Letra e
Nuk ka të dhëna					

POSEDIMI I KRIPTOVALUTËS

Nr.	Emri i kriptovalutës	Vlera e tanishme /€	Vlera e blerjes €	Sasia	Prejardhja	Data e pranimit	Letra e
Nuk ka të dhëna							

PARA TË GATSHME NË LLOGARI RRJEDHËSE, NË DEPOZITA DHE NË HUADHËNIE NË EURO OSE NË VALUTA TJERA TË HUAJA

Nr.	Lloji i të hyrave	Emri i institucionit	Vendi	Vlera/Çmimi	Prejardhja	Lloji i llogarisë	Pronësia e
1	Bank	Procredit Bank	Kosovë	53.48 Euro	Paga	Depozita/kursime	Deklaruesit
2	Bank	Procredit Bank	Kosovë	220.00 Euro	Paga	Depozita/kursime	Bashkëshortit/ës
3	Bank	Procredit Bank	Kosovë	50.00 Euro	Kursime	Depozita/kursime	Fëmijëve (me të cilët jeton në bashkësi familjare)
4	Bank	Procredit Bank	Kosovë	50.00 Euro	Kursime	Depozita/kursime	Fëmijëve (me të cilët jeton në bashkësi familjare)

TË DREJTAT DHE DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIK DHE FIZIK

Nr.	Kreditor (E Drejta)	Debitor (Detyrim)	Qëllimi i detyrimit financiar	Data e fillimit	Data e mbarimit	Kohëzgjatja (muaj)	Vlera Fillestare	Vlera e mbetur (aktuale)	Shuma totale e kredisë	Detyrimet e
1	Procredit Bank		Ndërtim Shtepie	29.07.2019	02.11.2029	120	30,000.00 €	20,987.21 €	30,000.00 €	Deklaruesit

DONACIONET NË PARTI POLITIKE

Lloji Donacionit	Parti politike	Vlera në €	Emërtimi	Data	Qëllimi	Pronësia
Nuk ka të dhëna						

DONACIONET DHE SHPENZIMET

Lloji Donacionit	Vlera në €	Emërtimi	Data	Qëllimi	Pronësia
Nuk ka të dhëna					

TË ARDHURAT VJETORE PERSONALE DHE FAMILJARE

Pronësia e	Lloji i të hyrave	Burimi	Vendi	Banka	Shuma /€	Teksti nese nuk ka
Deklaruesit			Kosovë	Cash	0.00	Perveq Pages nuk kam te ardhura tjera personale
Deklaruesit	Pagat neto përmes listës së pagave	Komuna e Kaçanikut	Kosovë	Procredit Bank	5,967.12 €	
Bashkëshortit/ës	Pagat neto përmes listës së pagave	Paga Nga Buixheti i Republikës së Kosovës	Kosovë	Procredit Bank	5,294.28 €	

TË DHËNA TË TJERA

--

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës Nr 03/L-212 I shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010, Punëdhënësi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin:

KONTRATË PUNE PËR KOHË TË CAKTUAR

Për projektin: **Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a.**
Me numer te prokurimit: **IL-24-8711-2-2-1**

Neni 1

Me këtë Kontratë: **NIKA Pro- Ing SH.P.K. – nga Ferizaj, me NUI; 811052307**, Të cilin e përfaqëson:
z. Korab Ferizi Person I Autorizuar lidhë kontratë pune me: **Izahir Kuka** I lindur me 04.06.1977 ne Bob, Kaqanik me nr personal: **1004563308**

Neni 2

I punësuari do të kryej këto detyra të punës: **Inxhinier i ndërtimtarisë - Hidroteknik**

Neni 3

I punësuari do të kryejë punët në: Lokalet e **NIKA Pro- Ing SH.P.K. – Ferizaj**, dhe në punishte.

Neni 4

I punësuari themelon marrëdhënie pune, në kohë të caktuar, duke filluar nga: **30.10.2024**, deri në perfundim te projektit,
(ne rast se fitohet tenderi: **Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.a.**
Me numer te prokurimit: **IL-24-8711-2-2-1**

Neni 5

Të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, në lartësi prej (Bruto): **550 euro.**

Neni 6

Punëdhënësi obligohet t'i paguajë kontributet për skemat pensionale të obligueshme dhe skemat e tjera të përcaktuara me Ligj.

Neni 7

Në asnjë rast, dispozitat e kësaj Kontrate nuk mund të jenë më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësit, se dispozitat e Ligjit të Punës ose të Kontratës Kolektive, për sa u përket të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënia juridike e punës. Për të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë përcaktuar me këtë Kontratë, zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e Ligjit të Punës dhe të Kontratës Kolektive. Për kontestet eventuale të moszbatimit të kësaj Kontrate, palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Neni 8

Pas njoftimit me përmbajtjen e Kontratës, kjo Kontratë nga palët kontraktuese u nënshkrua më datën: **30.10.2024**, në: Gjilan, në: tri /3/ kopje autentike, nga të cilat secilës palë i mbeten nga një kopje duke e përfshirë edhe noterin.

Punëdhënësi:
Nika Pro-ing shpk

Korab Ferizi - Person I autorizuar



I punësuari:


Izahir Kuka



Republika E Kosovës
Republika Kosova
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	02.08.2024	Vendi	Kaçanik
	Nj. org.		Numri	Shtoiçë
			01-370/01-10017/24	



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga z. Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"NIKA PRO-ING" Shpk, nga Ferizaji përfaqësuar nga i autorizuari Korab ferizi me nr. Personal 1500353577 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Rregullimi i hapsirave rekreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë

me numër identifikues: 652-24-6759-5-2-1

KA652/24/050/521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Rregullimi i hapsirave rekreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë

në < sipas dosjes > pjesë

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total është 73,643.96 € ,

dhe me fjalë: Shtatëdhjetëetremijëegjashtëqindëekatërdhjetëetreeuro e 96100 centë)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve dhe jo më pak se 15% e vlerës së kontratës .

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Korab Ferizi	Emri:	Izahir Kuka
Pozita:	I autorizuar	Pozita:	u.d. i Menaxherit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.08.2024	Data:	20.08.2024
Vula:		Vula:	



Kompania **NIKA Pro- Ing SH.P.K.** me seli në Ferizaj, me **NUI; 811052307** e përfaqësuar nga z. Shpend Musa, pronar dhe drejtor i kompanisë lëshon këtë:

REFERENCË

Për/For	Izahir Kuka
Data e lindjes/Date of birth	04.06.1977
Vendi i lindjes/Place of birth	Bob,Kaqanik
Pozita/Position	Inxhinier i Diplomuar i Hidroteknikes
Data e lëshimit/Issuing date	29.12.2023
Nga/From	z. Shpend Musa-Drejtor

Përmes kësaj shkrese vërtetojmë se **z. Izahir Kuka**, me profesion **Inxhinier i Diplomuar i Hidroteknikes** ka punuar në kompaninë me marrveshje për projekte të **NIKA Pro- Ing SH.P.K.** për projekte të ndryshme si ndërtimi,renovimi,etj. Dhe vazhdon ende punën profesionale në kompaninë tonë.

Z. Izahir Kuka ka qene i angazhuar si Ing Hidroteknik ne tenderin me titull:

I. Rekonstruimi dhe rindertimi I ujesjellsit ne fsh. Panqel dhe fsh. Ropotov e Madhe

Data e nenshkrimit Kontrates : 26.09.2023 dhe data e perfundimit 21.12.2023

Vlera Kontrates: 17,989.60 Euro

Me Nr Prokurimi: 661-23-8984-521

Dhe i ka kryer te gjitha punet ne menyre profesionale dhe sipas paramases ne bashkpunim me menaxheren e projektit.

NIKA Pro- Ing SH.P.K





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:085563

Datë: 02.08.2022

Numri i dokumentit: 03415269

CN.nr.298/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike jokontestimore sipas propozimit të propozuesit V.S nga Prishtina të cilin e përfaqëson av.Gazmend Rexhepi nga Ferizaj, e paraqitur ndaj kundër propozueses Komuna Ferizaj, të cilën e përfaqëson me autorizim Bekim Idrizi në çështjen juridike pagesën e diferencës së shumën në emër të shpronësimit, pas seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur më dt.22.07.2022, mori kurse me datën 02.08.2022, përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi propozimi i propozuesit V.S nga Prishtina përmes të cilës kërkuar që të **DETYROHET** Kundërpropozueseja Komuna Ferizaj që propozuesit tia paguaj diferencës e shumës në emër të shpronësimit për NK.nr.... sipërfaqja e shpronësuar prej 32797m², shumën prej 16€, për metër katror, apo shumën e përgjithshme prej 524,624.00€ (pesëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e katër euro), si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Propozuesi përmes të autorizuarit të tij në fjalën përfundimtare ka deklaruar mbesim në tërësi pranë propozimit të parashtruar pranë gjykatës dhe njëkohësisht ka kërkuar që të aprovohet propozimi i propozuesit për diferencën e shumës në emër të shpronësimit në shumë të përgjithshme prej 524,624.00 euro, e cila është baza urnë mendimin e ekspertit vlerësues Behar Jonuzi i cili e ka vlerësuar se çmimi real për metër katror është 24 euro kurse organi shpronësues e ka vlerësuar me 8 euro e që dallimi në mes asaj që ka vlerësuar organi shpronësues dhe eksperti është 16 euro e duke shumëzuar me sipërfaqen prej 32797 rezulton shuma prej 524.624 euro.

Sa i përket ekspertizës ka vlerësuar se e njëjta është profesionale është bazuar në metodën krahasuese pasi që ka marr për bazë tri kontrata të shitblerjes noteriale të cilat kanë qenë të përshtatshme për krahasim, për dallim që organi shpronësues në aktin e vlerësimit nuk shihet se ka marr për bazë ndonjë provë ku ka ardhur në përfundim të çmimi prej 8 euro për metër katror.

Andaj, ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovon në tërësi propozimin e propozuesit si të bazuar, ka kërkuar kamatën ligjore prej 7 %, si dhe shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i kundër propozueses në fjalën e tij ka deklaruar se edhe më tutje mbesim në tërësi pranë deklarimeve në seancat e kaluara duke shtuar se ky shpronësim i kësaj palujtshmerie është bërë për interes shoqëror për rregullimin e varrezave të qytetit të Komunës së Ferizaj, ku organi shpronësues ka vlerësuar se çmimi real i tregut ka qenë 8 euro për metër katror apo në shumë prej 262.384 euro të cilën shumë i është paguar propozuesit, sa i përket mendimit të ekspertit Behar Januzi kjo ekspertizë është e pa bazuar, e njëjta është në kundërshtim me provat materiale për arsye se ka marr për bazë një kontratë noteriale të palujtshmerise e cila ka qasje drejtpërdrejtë në magjistralen Ferizaj-Shkup, e cila është e përshtatshme për biznes kurse prona objekt shpronësimit është në thellësi nga rruga kryesore prej 400-500m me çka kemi të bëjmë me një rritje prej 200%, me çka nuk ka qenë reale dhe në përputhje me çmimin e tregut.

Kundër propozuesja ka theksuar se është e panevojshme të nxjerrët provë tjetër nga lëmia me ekspert vlerësues pasi që ka theksuar se provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë aktgjykimi i kësaj Gjykate shihet se në vitin 2002 kur është blerë kjo prona ka pasur vlerë prej 108.000€, kurse organi shpronësues e ka vlerësuar në shumë prej 262.384 euro që është çmim real i tregut kurse pjesën që e ka vlerësuar eksperti nuk është në përputhje me çmimin e tregut pasi që i njëjti e ka vlerësuar në shumë prej 787.000€, ku dhe ka kërkuar që mos t'ia fal besimin mendimi të ekspertit vlerësuar Behar Jonuzi.

Andaj i ka propozuar gjykatës që propozimin e propozuesit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar, kurse të në fuqi vendimin përfundimtar të shpronësimit me nr. 10.NR.465-15 e datës 26.07.2019, edhe aktin e vlerësimit të punuar nga Ministria e Financave.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe vlerësimit të drejtë të kësaj çështje ka bërë administrimin e provave U lexua vendimi përfundimtare i nxjerr nga Komuna Ferizaj me numër 10. Nr.465-15 dt.26.07.2019, të bashkangjitur me shkresat përcjellëse të vlerësimit,

aktvendimi i nxjerr nga ZKK-Ferizaj me nr. 45357-2020 dt. 03.07.2020, autorizimi i propozuesit i dhënë av.Gazmend Rexhepi, fleta poseduese e dt. 09.07.2022 për NK ... në emër të propozuesit , aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.60/15 e dt. 20.10.2019, autorizimi i kundër propozuesit dhënë përfaqësuesit Bekim Idrizi, parashtrës e dt. 20.10.2021 dorëzuar nga autorizuesi i propozuesit të bashkangjitur 3 kontrata noteriale, ekspertiza e ekspertit Behar Januzi dt. 14.11.2021, shikimi i tri ofertave që i dorëzoi sot eksperti.

Gjykata pas administrimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 3 të LPJ lidhur me nenit 8 të LPK ka vendosur që propozimi është i pabazuar.

Gjykata ka marr shkresat e lëndës ka udhëhequr procedurën sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Jo Kontestimore, për caktimin e kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar, me qëllim të vlerësimit të drejtë të kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar sipas vendimit përfundimtar të nxjerrë nga ana e Komunës së Ferizajt sipas të cilit vendim ka bërë shpronësimin e paluajtshmërsë të propozuesit e për të cilën ia ka ofruar vlerën për m2, për NK.nr.... në sipërfaqe prej 32797 me çmim prej 8€, për metër katror për interesat e të cilit është bërë ky shpronësim, për zgjerimin e varrezave të qytetit e të cilin e ka kundërshtuar propozuesi, ku ndaj të njëjtit vendim ka paraqitur ankesë –propozim në gjykatë.

Gjykata me anë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.60/15 ka vërtetuar se paditësi në vitin 2002, e ka blerë pronën objekt shpronësimi në vlerë prej 108.000€.

Organi shpronësues për interesat e të cilit është bërë ky shpronësim e ka vlerësuar se kjo pronë në periudhën kur është bërë shpronësimi në vitin 2019, e ka vlerësuar me 8€ për metër katror apo në shumë të përgjithshme prej 262.376€

Gjykata përmes nxjerrjes së provës me ekspertizë të vlerësimit të paluajtshmërisë të përpiluar nga eksperti Behar Januzi e datës 14.12.2021 dhe sqarimeve të dhëna në seancën e datës 22.07.2022, i cili ekspert e ka vlerësuar se sipas çmimit të tregut kjo pronë është vlerësuar nga 24€, për metër katror dhe sipas ekspertit diferenca në mes vlerësimit të organit shpronësues prej 8€ për metër katror dhe çmimit të tregut për këtë paluajtshmëri objekt shpronësimi është 16€, apo diferenca është në shumë prej 524.624€, ku si bazë ka marr tri kontratat e shitblerjes e të cilat ka vlerësuar se kanë qenë të përshtatshme për krahasim, eksperti ka sqaruar se meqenëse të njëjtat për nga vlera kanë qenë më të larta, por duke u bazuar në matricën e axhustimeve

(qasja e shitjeve), të bëra ka ardhur në përfundim deri te çmimi i tregut prej 24 euro për metër katror

Andaj gjykata mendimit të ekspertit Behar Januzi nuk ia ka falur besimin pasi që i njëjti ekspertizën e tij e ka bazuar në kontratat noteriale të shitblerjes të cilat prona kanë pasur qasje të drejtpërdrejtë në rrugën kryesore Prishtinë-Shkup, e të cilat janë të përshtatshme zhvillimin e veprimtarive biznesore ku dhe ushtrohet, për dallim të asaj që prona objekt shpronësimi është në brendësi rreth 400-500m, e cila nuk ka pasur qasje në infrastrukturë siç është rryma, uji rruga etj e kjo shihet çart në faqe 5 ku është i kufizuar lokacioni i pronës objekt shpronësimi ku eksperti ka konstatua në pjesën e sipërme se prona ka qasje në rrugën e pa asfaltuar dhe në brendësi 100, të cilin konstatim gjykata nuk është pajtuar për faktin se rruga të cilën pretendon eksperti se është e pa asfaltuar i referohet rrugës së bërë nga Komuna e Ferizajt për nevojat e varrezave siç shihet në faqe 7 dhe 8 të ekspertizës.

Në faqe 11 të ekspertizës, kontratat e shitblerjes që ka marr për bazë dhe atë me numër referencës 1 dhe 3 kanë qasje të drejtpërdrejtë në rrugën kryesore, kurse kontrata me numër reference 3 e njëjta nuk ka qasje në rrugën kryesore por ka qasje të drejtpërdrejtë në rrugën e fshatit e cila ka infrastrukturë përcjellëse rrugë e asfaltuar, ujë, kanalizim etj.

Përveç kësaj gjykata vlerëson se kontratat të cilat i ka marr për bazë eksperti nuk kanë qenë të përshtatshme për krahasim për faktin se asnjëra nga tri pronat të cilat i ka marr për bazë kontratat e shitblerjes nuk ka sipërfaqe njëjtë apo të përafërt me pronën objekt shpronësimi por janë për nga sipërfaqja shumë më të vogla, pronat me numër reference 1 dhe 3 kanë qasje të drejtpërdrejtë në rrugën kryesore të njëjtat kanë qasje në infrastrukturë, kurse prona me numër reference 2 e njëjta ka qasje në rrugën e fshatit e cila gjithashtu ka qasje në infrastrukturë, për dallim që prona objekt shpronësimi i kanë munguar këto elemente, andaj gjykata vlerëson se edhe përkundër asaj që eksperti në mendimin e tij dhe sqarimeve të dhëna ka përdorur matricën e axhustimeve (qasjen e shitjeve krahasuese) e çmimit gjykata vlerëson se këto kontrata nuk ka gjetur se janë të përshtatshme për krahasim dhe mbi këto arsye nuk ia ka falur besimin mendimit të ekspertit vlerësues Behar Jonuzi, pasi që i njëjti ka qenë kontradiktor.

Gjykata duke e vlerësuar në mënyrë të gjithanshme, e duke e sqaruar në mënyrë të qartë, duke marr parasysh të dhënat për pronën, karakteristikat e zonës, dhe kushteve specifike duke marr parasysh metodën e vlerësimit të përdorur nga ana organit shpronësues, gjykata në rastin

konkretë ia ka falur besimin mendimin dhe konstatimin organit shpronësues si objektive i cili këtë pronë e ka vlerësuar sipas çmimi i caktuar për metër katror prej 8€ si çmim real e që përputhet me çmimit të tregut, pasi që duke marr parasysh se në periudhën se kur është blerë kjo pronë në vitin 2002 ka pasur vlerë të tregut 108.000, kurse në vitin 2019 kur është bërë shpronësimi ka pasur vlerë të tregut 262.376€, që për këtë periudhë kemi një rritje të çmimit të tregut mbi 100%, e cila ngritje është e arsyeshëm dhe reale për dallim që vlerën që e ka përcaktuar eksperti e i cili është bazuar në kontratat jo të përshtatshme për krahasim ka një ngritje mbi 600%, e cila ngritje dhe i cili çmim i tregut nuk është real.

Gjykata me rastin e vendosjes ka marr parasysh edhe pretendimet tjera të propozuesit por nuk ka gjetur bazë për të vendosur ndryshme për dallim të asaj që ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata sa i përket shpenzimeve procedurale e ka bazuar në nenin 3 të LPJ-së, lidhur me nenin 450.1 të LPK-së, që secila palë ti bart shpenzimet e veta.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv ët këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
CN.nr.298/20 më dt.02.08.2022.

Gjyqtari,
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0613

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi - Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Albi Company” SH.P.K. kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të “Kuvendi I Komunës se Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “84 Renovime dhe mirëmbajtja e Institucioneve vartëse dhe hapësirave kulturore” me nr. të prokurimit: “616-24-3683-5-2-1”, me 30/08/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Albi Company” SH.P.K. me nr. 2024/613, e datës 03/07/2024, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës “84 Renovime dhe mirëmbajtja e Institucioneve vartëse dhe hapësirave kulturore”
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 19.06.2024.
3. Detyrohet Autoriteti Kontraktues për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtoj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 17.04.2024 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “84 Renovime dhe mirembajtje e Institucioneve vartese dhe hapësirave kulturore” me numër të prokurimit 616-24-3683-5-2-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për shërbim, me vlerë të parashikuar 100,000.00€.

Me datë 19.06.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë OE “Bajramit Ha Gashi BI- BG Ing”.

Me datë 21.06.2024, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 01.07.2024.

Me datë 09.07.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0589.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë se tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, kapacitetin ekonomik dhe financiar si dhe specifikat teknike.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0613 ndërsa me datë 03.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesësisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”*.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Lidhur me pretendimin nr. 1 – *“Sa i perket arsyës se pare te eliminimit nga AK te OE ankues lidhur me kete aktivitet te prkurimit e qe ka te beje me marrveshjen e prezantuar nga OE ankues, lidhur me kete, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën*

e-prokurim, përkatësisht dokumentacionin ne oferten e OE ankues, bazuar në kërkesën e lartcekur ne dosjen e tenderit, kërkesa dhe deshmite per listen e mjeteve ka qene qe: “Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, ndersa OE ankues, me oferten e tij ka dorezuar “MARRËVESHJE MBI QIRAMARRJEN E AUTOMJETEVE, ndermjet OE "Musa Ibercuk "shpk Piran dhe OE "Albi Company"shpk Rahovec”, mirepo kjo marreveshje nuk eshte e noterizuar sipas kerkeses se dosjes se tenderit, prandaj si e tillë, nuk e permbush kerkesen e dosjes se tenderit te percaktuar nga AK. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues ne kete pike eshte i pa Ndersa, sa i perket arsyes se dyte per eliminimin e OE ankues, e qe ka te beje me kerkesen e dosjes se tenderit “4.Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj se sistemi menaxhues i ofertuesit përmbush kriteret e përcaktuara në fushën e ndërtimtarisë së paku për këto ISO standard si ne vijim -ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë -ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor - EN ISO 45001 2018 - Certifikata për menaxhimin e shëndetit në punë”. lidhur me kete, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim, përkatësisht dokumentacionin ne oferten e OE ankues, Eksperti shqyrtues sqaron se, OE ankues me oferten e tij ka dorezuar certifikatat perkatese sipas kerkeses ne dosjen e tenderit te percaktuara nga AK. Andaj pretendimi i OE ankues ne kete pike eshte i bazuar

Lidhur me pretendimin nr. 2 - *“Sa i perket Draft Kontrates – Konserciumit te prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, edhe pse eshte titulluar si draft-kontrate, konsideroj se, ky dokument i permban te gjitha kushtet dhe elementet per tu konsideruar si dokument apo marreveshje e pranueshme dhe se ceshtja e emertimit nuk duhet te merret si dicka e papranueshme, per faktin se, ne kete dokument jane percaktuar rregullat dhe kushtet e paleve, e per te cilat palet jane pajtuar dhe si rrjedhoje kane nenshkruar dhe vulosur kete marreveshje, prandaj si dokument konsiderohet i pranueshem meqenese eshte i nenshkruar nga palet e marreveshjes pavaresisht emertimit te dokumentit. Gjithashtu, ceshtja e renditjes se grupit ne formularin e dorezimit mund te konsiderohet vetem gabim teknik duke qene se, ne kete draft kontrate definohet qarte roli dhe pergjegjesite e grupit per kete aktivitet te prokurimit. Prandaj pretendimi i OE ankues ne kete pike eshte i pa bazuar”.*

Lidhur me pretendimin nr. 3 - *“Sa i përket pretendimit ankimor se “Menaxherja e caktuar znj, ISUFI nuk posedon përvije pune 5 vite pas diplomimit me referenca nga punedhesi me titull Master, pasiqe e njejta para dates 21.11.2019 ka poseduar vetem Titullin Bachelore e Nderimtarise”, lidhur me këtë, Eksperti shqyrtues sqaron se, ne dosjen e tenderit, AK ka kerkuar “Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë -drejtimi Konstruktiv, me 5 vite përvijë pune pas diplomit, të jetë menaxher i projektit , i trajnuar për mbrojtje dhe siguri në AK gjate vleresimit te tendereve e ka evidentuar se per znj Arta Isufi mungon referenca e punes, referenca jo e mjaftueshme 5 vite përvije pune , AK sipas nenit 59 dhe nenin 72 të LPP-së, permes Letres Standarde (B47) te kërkesës për sqarimin e tenderit me date 11.06.2024 ka kerkur sqarime nga OE i rekomanduar per kontrate, ndersa OE i ka ofruar sqarimet duke bashkangjitur reference per znj. Arta Kuqi, pra nuk eshte prezantuar referenca per znj, Arta Isufi sipas kerkese se AK. Andaj, bazuar ne kërkesen e lartcitur te dosjes se tenderit, si dhe ne baze te deshmive te prezentuara me oferte nga OE i rekomanduar znj, ARTA ISUFInuk deshmohet se e njejta e ploteson kerkesen e dosjes se tenderit per inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi Konstruktiv, per faktin se ne e tenderit eshte kerkuar inxhinier i diplomuar i*

ndërtimatisë -drejtimi Konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomit, ndërsa OE i rekomanduar për të njëjten ka dorëzuar deshmive diplomën e nivelit master në të cilën evidentohet se data e diplomimit është 21.11.2019, prandaj si e tillë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar”.

Lidhur me pretendimin nr. 4 -
“Sa i përket pretendimit ankimor se “z.Albert Bylykbashi nuk posedon përvojë pune 5 vite pas diplomimit”, lidhur me këtë, Eksperti shqyrtues sqaron se, në dosjen e tenderit, AK ka kërkuar “-

(1) inxhinier i makinerisë drejtimi Termoteknikë dhe Termoenergjetikë, me minimum 5 vite Sipas kërkesës së lartcitur të dosjes së tenderit, në bazë të deshmive të prezentuara me oferte nga OE i rekomanduar z. Albert Bylykbashi nuk deshmohet se i njëjti e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për inxhinier i makinerisë drejtimi Termoteknikë dhe Termoenergjetikë, me minimum 5 vite përvojë pune, për faktin se nuk ka prezantuar deshmë mbi përvojën e punës, 5 vite përvojë pune, sipas kërkesës në dosjen e tenderit, prandaj si e tillë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Ndërsa, sa i përket pretendimit të Diploma Master z.Albert Bylykbashi, nuk është ORIGINAL, lidhur me këtë sqarohet se, AK në dosjen e tenderit ka kërkuar “2.Lista e stafit të bashkuar me Diplomat, CV-it, Kontratën e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, referencat e punës”.Pra, sjellja e diplomes origjinale nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar”.

Lidhur me pretendimin nr. 5 – *“Sa i përket pretendimit ankimor se “z.Shkelzen Rexha dhe z. Shkelzen Nushise të njëjtit kanë ofruar referencë me informata të rrëjshme”, lidhur me këtë sqarohet se, për çdo paqartësi lidhur me deshmive për listën e stafit, AK ka mundur të kërkojë sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të nenit 72 të këtij ligji, AK-të mund të kërkojnë nga OE-të që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë ndonjë dëshmi të specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderit dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Gjithashtu, Kurdo që AK ka dyshime lidhur me dokumentet e tenderit mund ta bëjë verifikimin e tyre në përputhje me paragrafin 7 të nenit 52 të LPP-së”.*

Lidhur me pretendimin nr. 6 – *“Sa i përket pretendimit ankimor se “Diploma e Teknikut të Elektroteknikës të shkolles Mesme të z. Qamil Bektashi nr 1168/82 NUK ËSHTË E NOTERIZUAR siq është kërkuar në deshmën nr 3”, lidhur me këtë, Eksperti shqyrtues sqaron se, në dosjen e tenderit, AK ka kërkuar “-“2.Lista e stafit të bashkuar me Diplomat, CV-it, Kontratën e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, referencat e punës”. Bazuar në kërkesën e lartcitur të dosjes së tenderit ky pretendim i OE ankues nuk qëndron për faktin se, sjellja e diplomes së noterizuar nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar”.*

Lidhur me pretendimin nr. 7 - “Sa i përket pretendimit ankimor se “Gr OEFitues nuk ka dorezuar Nje salldues I Certifikuar – ku certifikata duhet e noterizuar”, lidhur më këtë, Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar ne deshmitë e prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, ne listen e punetreve eshte prezantuar edhe z. Granit Cikaqi si salldues. Duke qene se ne oferten e OE te rekomanduar per kontrate ka munguar certifikata e trajnimit per salldues, AK gjate vleresimit te tendereve e ka evidentuar se per te njejtin mungon certifikata e trajnimit per salldues, andaj ne rastin konkret AK ka vepruar në pajtim me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, ku permes Letres Standarde (B47) te kërkesës për sqarimin e tenderit me date 11.06.2024 ka kerkur sqarime nga OE i rekomanduar per kontrate, ndersa OE i ka ofruar sqarimet duke bashkangjitur certifikaten perkatese te z. Granit Cikaqi te noterizuar sipas kerkeses se dosjes se ”.

Lidhur me pretendimin nr. 8 - “Sa i përket pretendimit ankimor se “Gr OE fitues NUK ka dorezuar se paku nje MAKINE PER GRRYERJEN E GLETIT”, lidhur më këtë, Eksperti shqyrtues sqaron se,AK-se për listën e pajisjeve ne pikën 3 te aneksit 7 te dosjes se tenderit, ka kërkuar: “Se paku nje makine per grryerjen e gletit”, ndersa OE i rekomanduar per kete kerkese te dosjes ne listen e pajisjeve ka paraqitur “Rrafshues gleti” ku per te cilen ka sjellur deshmi fature me nr 44, andaj sipas ketij pershkrimi te pajisjes është vështirë për te konstatuar se kjo pajisje-makineri i përgjigjet kërkesës ne dosjen e tenderit, si dhe kryen te njëjtin funksion te një “MAKINE PER GRRYERJEN E GLETIT” siç është kërkuar ne dosjen e tenderit. Megjithatë, meqenëse është plotesu aneksi 7 me te dhënat për pajisjet përkatëse, lidhur me këtë, AK sipas nenit 59 dhe 72 te LPP-se mund te kërkoj sqarime- dëshmi shtese nga OE i rekomanduar lidhur me te dhënat për pajisjen e prezantuar për ta sqaruar se te dhënat e paraqitura nga OE e plotësojnë ose jo piken 3 te aneksit 7 te dosjes se tenderit. Bazuar ne sqarimet e lartpërmendura, pretendimi i OE ankues ne këtë pike është i ”.

Lidhur me pretendimin nr. 9 - “Sa i përket pretendimit ankimor se “Ne kete Marreveshja bashkpunimi mbi dhenejen ne shfrytezim te mjeteve themelore te punes e lidhure ndermjet OE Alpe shpk dhe OE BG Ing e dates 26.06.2023 NJUK JANE TE PERSHKRUAR SE CILAT PAISJE MIRREN/JEPEN ME QIRA. E njejta MARREVESHJE e paisje NUK eshte per projektin ne fjale dhe meqense daton qe nga data 26.06.2023”, lidhur më këtë, Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar ne deshmitë e prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, ne oferten e tij ka prezantuar Marreveshjen e bashkpunimit mbi dhenejen ne shfrytezim te mjeteve themelore te punes ndermjet OE Alpe shpk dhe OE BG Ing e dates 26.06.2023, ne te cilen eshte bashkangjitur edhe lista e pasjijeve me pershkrimet perkatese, prandaj pretendimi i OE ankues ne kete pike eshte i pa bazuar”.

Lidhur me pretendimin nr. 10 - “Sa i përket pretendimit ankimor se “OE i rekomanduar ka paraqitur akt noterizimi mashtrues dhe me informata te rrejshme”, lidhur me kete sqarojme se, argumentimi dhe konstatimi i këtij pretendimi ankimor është përtej mundësive dhe kapaciteteve të ekspertit shqyrtues, megjithatë, kurdo që OE ka dyshime të bazuara lidhur me këtë çështje, mund ti drejtohet organeve kompetente, per me teper, është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së. Pra, AK gjate vleresimit te tendereve, kurdo qe AK ka dyshime lidhur me dokumentet e tenderit mund ta beje verifikimin e tyre në përputhje me paragrafin 7 të nenit 52 të LPP-së”.

Lidhur me pretendimin nr. 11 – “Sa i përket pretendimit ankimor se “Ak-se nuk respektojnë nenin 61 LPP dhe nenin 41 Rregullores 001/2022 që kërkojnë sqarime për Tender Jo normalisht të ulet apo të lartë. Gr OE fitues ka ofruar qmime mashtruse ndaj AK-se, duke ofruar qmime teper të ulet në krahasim me tregun për pozicionet që nuk janë të nevojshme për tu realizuara gjatë ekzekutimit të kontratës dhe ka ofruar qmime teper të lartë në krahasim me tregun për pozicionet që janë me se të nevojshme për tu realizuara gjatë ekzekutimit të kontratës”, lidhur me këto sqarime se: AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit, sipas përshkrimit teknik në paramasën dhe paralogarinë të dhënë në dosjen e tenderit pozicionet nuk janë të ndara të rëndësishme po të pa rëndësishme në kuptimin e realizimit të tyre, prandaj nuk mund të thuhet se qmime e ofruara nga OE i rekomanduar janë teper të ulet në krahasim me tregun për pozicionetpozicionet e caktuara për shkak se nuk janë të nevojshme për tu realizuara gjatë ekzekutimit të kontratës. Është përgjegjësi dhe në diskrecion i Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së”.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat

dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues ka gjetur që sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, AK e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit OE ankues si tenderues të papërgjegjshëm për arsyet si në vijim: *“GOE Albi Company ShPK & Raf II ShPK në dëshmitë e ofruara në ofertën e tyre për aneksin 1 për pajisjet e kërkuara ka marrëveshje për qiramarrjen e automjeteve me OE Musa Ibercuk të datës 26.04.2024 por e cila marrëveshje nuk është e noterizuar sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Gjithashtu në kërkesën lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale ku kërkohet pika 4. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se sistemi menaxhues i ofertuesit përmbush kriteret e përcaktuara në fushën e ndërtimitarisë së paku për ISO standardet në vijim ISO 9001 2015 çertifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë, ISO 14001 2015 sistemi i menaxhimit mjedisor, EN ISO 45001 2018 çertifikata për menaxhimin e shëndetit në punë. GOE për këtë kërkesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi në ofertën e tyre...”*.

Tutje Paneli Shqyrtues ka gjetur se përmes kërkesës për rishqyrtim të drejtuar ndaj AK, të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë. Asnjë nga pretendimet ankimore nuk i kontestojnë të gjeturat e AK sipas të cilave OE ankues ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Rrjedhimisht ankuesi nuk ka arritur që të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime ankimore të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë përderisa vet ankuesi kishte dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Kriteri i dhënies së tenderit është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Ndërsa përmes nenit 59.1 të RRPP është përcaktuar se *“Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar...”*.

Përmes ankesës 2024/0613, operatorit ekonomik ankues ka shtuar dy pretendime ankimore (pretendimin e parë dhe të dytë) të drejtuara kundër arsyeve për eliminim sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar. Fillimisht duhet cekur se këto pretendime janë pretendime të cilat nuk kanë qenë të parashtruara përmes kërkesës për rishqyrtim dhe si të tilla nuk kanë qenë objekt i tentimit për zgjidhje miqësore mosmarrëveshje e cila duhet t'i paraprijë parashtrimin të ankesës në kuptim të nenit 108A dhe 109 të LPP. Këtë fakt nuk e ka elaboruar fare në raportin e vet eksperti shqyrtues. Mirëpo edhe po të mos merren parasysh fare këto rrethana juridike, duhet theksuar që as eksperti shqyrtues nuk e ka kontestuar faktin që operatorit ekonomik ankues ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Kjo pasi që edhe eksperti shqyrtues e ka gjetur si të pabazuar pretendimin e parë ankimor. Në këtë mënyrë është konfirmuar se oferta e operatorit ekonomik ankues është ofertë e papërgjegjshme. Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të OE ankues,

duhet cekur se përderisa oferta e ankuesit është e papërgjegjshme, vet ankuesi nuk mund të dëshmoj asnjë interes material në rast të rivlerësimit në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Mirëpo përtej këtyre fakteve, vlen të theksohet se autoriteti kontraktues e gëzon autonominë e plotë për të ekzaminuar, krahasuar edhe vlerësuar të gjitha ofertat e pranuar në një aktivitet të prokurimit. Duke qenë se në rastin konkret AK ka vlerësuar dokumentet në mënyrën e elaboruar si më sipër, nuk ekziston bazë e mjaftueshme për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit vetëm sa i përket këtij fakti. Përndryshe AK e gëzon të drejtën që në rast të nevojës të kërkoj edhe garancione shtesë nga tenderuesi i rekomanduar me rastin e lidhjes së kontratës.

Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqjen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe faktin se ankuesi ka ofertuar me çmim dukshëm më të lartë sesa OE i rekomanduar për kontratë. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e buxhetit publik të AK.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 19.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “84 Renovime dhe mirembajtje e Institucioneve vartese dhe hapësirave kulturore” me numër të prokurimit 616-24 3683-5-2-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsytet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - "ALBI COMPANY" SH.P.K**
- Arkivës së OSHP-së: